



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:165351

Datë: 19.08.2024

Numri i dokumentit: 06061006

P.nr.394/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. N. nga fsh. K. K. D., të cilin e mbronë Blerim Qela av. nga Prishtina, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.4448/23 të dt.10.08.2023, për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 12.08.2024, në prani të prokurorit të shtetit Paulin Pashku, të pandehurit dhe mbrojtësit Blerim Qela av., në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

A. N., i lindur me dt...., në fsh. K. K. D., ku edhe jeton, i biri Z., nënës F., gjinisë B., i martuar, baba i një fëmijës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Më datë 06.06.2023 rreth orës 08:03h, i pandehuri A. N., në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", me dashje ka përdorur dokumentin e falsifikuar si origjinal, në atë mënyrë që gjatë udhëtimit në shkuarje për në Vjenë, zyrtareve kompetente iu ka prezantuar Leje qëndrimin S. nr: ..., e cila leje dyshohej se ishte e falsifikuar ashtu që përmes vërtetimit të lëshuar nga policia sekuestrohet përkohësisht, me ç'rast sipas raportit të ekspertimit AKF/2023-1820/23-1685 i lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, respektivisht nga specialisti i lartë për dokumente dhe dorëshkrime jepet konstatimi me mendimin përfundimtar se dokumenti i evidentuar në dëshminë #1, e që është leje qëndrimi S.. nr: ... ka rezultuar se është falsifikim i plotë,

- Me çka ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 79 dhe nenit 390 par. 1 të KPPK-së, si dhe nenit 364 te KPPK-se, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumën prej 20-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin për Kompensimin e Viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

KONFISKOHET dokumenti i falsifikuar Leje qëndrimin S. nr: ... e lëshuar në emër të te pandehurit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4448/23 të dt.10.08.2023, e ka akuzuar të pandehurin A. N. nga fsh. K. K. D., për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore në dispozitat e KPPK-së, duke i propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se ndihet i penduar për veprën penale të kryer, nuk do ta përsërit në të ardhmen vepër të ngjashme, e ka lutur gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë, është i pa punë, i gjendjes jo të mirë ekonomike.

Mbrojtësi i të pandehurit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e mbështet deklarinimin e të mbrojturit lidhur me pranimin e fajësisë, është konsultuar mjaftueshëm, i njëjti i ka kuptuar benefitet dhe pasojat që rrjedhin nga pranimi i fajësisë, njëkohësisht gjatë kësaj procedure ka qenë bashkëpunues dhe është munduar që të evitoj pasojat e kësaj veprë penale pasi që të njëjtin e ka kryer pa dijenin e tij dhe se për këto arsyeje ka shprehur keqardhje. Duke e lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë, një dënim me gjobë pasi që në këtë rast ka qenë i dëmtuar financiarisht dhe se çdo dënim ndryshe nuk do të ketë ndonjë efekt më të rënd se sa pasojat që janë krijuar në këtë rast.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, dha pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konform nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Rrethana lehtësuese dhe rënduese me rastin e caktimit të dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishum i shoqërisë, është mbajtës i familjes, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veçanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi

shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me gjobë konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 20-€ u caktua në emër të paushallit gjyqësor në bazë të ndërlikshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskim

Vendimi për konfiskim u bazua në nenin 276 par. 2 nenpar. 2.5 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
P.nr.394/23 dt.12.08.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:165351
Datë: 19.08.2024
Numri i dokumentit: 06061006